



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 327, datë 14.06.2023

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL, TË
GJYQTARES SË KOMANDUAR NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR, ZNJ.{...},
PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 10.02.2020-21.11.2022**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat a) dhe ë) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 68 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 61, pika 1, nenin 63 dhe nenin 86, shkronja dh), të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 159, datë 05.04.2023 “Rregullat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.70 datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, pas verifikimit të plotësimit nga gjyqtarja znj.{...} të kriterëve të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e shpallur me vendimet nr. 499, nr. 501 dhe nr. 502, datë 21.11.2022, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe pas shortit të realizuar,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 10.02.2020 - 21.11.2022, për gjyqtaren e komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, znj.{...}, gjatë ushtrimit të detyrës së këshilltares ligjore pranë Njësisë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e znj.Irena Plaku si relatores për vlerësimin e gjyqtares së komanduar, znj. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KRYETARE